

*Te ardhurat e realizuara ne total jane perdorur per financimin e funksioneve te veta te percaktuara si me poshte:*

- *Pagat e personelit,*
- *Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të personelit.*
- *Për shpenzime operative*
- *Investime*
- *Bashkefinancim Projekte te BE*
- *Investime ne infrastrukture sipas propozimeve te bashkive dhe miratimit ne Keshillin e Qarkut*

### **Te ardhura nga fondet e kushtezuara per periudhen 8/mujore**

Gjatë 8 mujorit të vitit 2018, Këshilli i Qarkut për përmbushjen e funksioneve të deleguara, ka përfituar nga buxheti i shtetit fonde të kushtëzuara, buxhetore për shpenzime në shumën prej **4701 mijë** lekë. Keto fonde jane perdorur per financimin e aktivitetit te Drejtorise se Administrimit dhe Mbrojtjes ne Qark e cila eshte funksion i deleguar. Ky akordim është kryer në mbështetje të programit fillestar të buxhetit të shtetit.

#### ➤ **Analiza e realizimit te shpenzimeve per periudhen 8/mujore 2018**

Shpenzimet e buxhetit gjatë 8-mujorit të vitit 2018 janë realizuar në shumën prej **29197 mijë lekë** ose e shprehur në përqindje **30 %** ndaj programimit 8/ mujor prej **97428 mijë** leke.

Nga totali i shpenzimeve per periudhen 8/mujore, shpenzimet korrente janë realizuar në shumën prej **29197 mijë leke ose 75.4 %** ndaj planit prej **38717 mijë** leke sipas programeve te miratuara per administraten e keshillit te qarkut dhe drejtorine e DAMT ne qark. Shpenzimet kapitale për periudhen 8/ mujore jane ne nivelin zero pasi realizimi i tyre do te behet ne katermujorin e fundit. Kjo lidhet se pari me plotesimin e dokumentacionit te nevojshem per fillimin e proceduarve te prokurimit per investimet e miratuara me perfitues bashkite e qarkut. Aktualisht keto investime jane ne fazen e prokurimit. Gjithashtu investimet e vete institucionit lidhen me levizjen e institucionit ne ambjenjtet e reja qe do te ndodhe ne kete periudhe aktuale.

### **Realizimi i Shpenzimeve për 8/ mujorin e 2018 paraqiten si me poshte**

Ne 000/leke

Nr.	Emertimi sipas Programeve	Plan	Fakt	Diferenca	% realizim
<b>1</b>	<b>Administrata – Programi 01110</b>	<b>51323</b>	<b>24975</b>	<b>26348</b>	<b>48.66</b>
	Paga personeli	12400	9886	2514	79.7
	Sigurime shoqerore e shendetsore	2100	1915	185	91.2
	Shpenzime operative, keshilltare e vendime gjyqesore	16246	10488	5758	64.56
	Transferta korente te brendshme	3270	2686	584	82.1
	Nga keto:				